Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0283

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Agon Ramadani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE "Flomed" sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe ankesës së OE "S.V.Veterina" me seli në Vushtrri kundër vendimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në objektet Policore." me numër të prokurimit 214-22-5200-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK)-Policia e Kosovës, më 24/07/2023, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohen pjesërisht të bazuara, ankesa e OE "Flomed" sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe ankesa e OE "S.V.Veterina" me seli në Vushtrri, vendimi për dhënie lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në objektet Policore", me numër të prokurimit 214-22-5200-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues-Policia e Kosovës, anulohet, ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në ri-vlerësim.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mosrespektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë.

3. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesave. OE ankuese obligohen që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 10.06.2023, Policia e Kosovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë. Me datën 10.02.2023, AK ka publikuar formularin për Korrigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara.

Me datë 28.04.2023, ka publikuar B58 njoftimin mbi vendimin për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbime të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit në objektet Policore.", me numër të prokurimit 214-22-5200-2-1-1, ku është rekomanduar për kontratë ku është rekomanduar për kontratë OE "Doctor Exterminator DDD" sh.p.k.

OE "Flomed" sh.p.k.,me datën 03.05.2023, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 11.05.2023, AK - Policia e Kosovës, me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues "Flomed" sh.p.k.,me vendimin e AK me datë 15.05.2023, ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0283.

Me datë 03.05.2023, Operatori Ekonomik "S.V.Veterina" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Policia e Kosovës, me datë 11.05.2023 AK e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim dhe ka vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e AK të datës 28.04.2023,për dhënie të kantatës për aktivitetin e prokurimit të sipër shënuar.

Me datën 22.05.2023, Operatori Ekonomik "S.V.Veterina" , ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 292/2023, kundër B58 Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 379,614.27 €

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 29.05.2023 me raportin e ekspertizës.

Me datë 31.05.2023 AK Policia e Kosovës, ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq OE "S.V.Veterina" me datë 01.06.2023,ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa OE "Flomed" sh.p.k. nuk është deklaruar.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Autoriteti Kontraktues-Policia e Kosovës gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës shërbim. Vlera e parashikuar 379 614,27 €. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

OSHP ka angazhuar ekspertët e jashtëm shqyrtues të prokurimit që në pajtim nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e ekspertizës së datës 29 maj 2023, për lëndën 293/2023, ka rekomanduar që:

- Aprovohen si të bazuara ankesat e "S.V.Veterina"
- Lënda të kthehet në Ri-vlerësim

Ndërsa, raportin e ekspertizës së datës 16 qershor 2023, për lëndën 283//2023 ka rekomanduar që

- Aprovohen si të bazuara ankesat e "Flomed" sh.p.k.
- Të anulohet në tërësi aktiviteti i prokurimit i sipër shënuar.

-Konstatimet e Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Në bazë të këtyre shkresave PSH u ndal tek çështja kryesore për këtë aktivitet të prokurimit lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues "Flomed" shpk, sa i përket përdorimit të preparateve që përmaban specifikimi teknik në këtë aktivitet të prokurimit si dhe preparateve të ofertuara nga OE ankues. Arsyet pse PSH u ndal tek trajtimi i këtyre pretendimeve ankimore është pikërisht për shkak të interesit publik sa i përket shëndetit të qytetarëve. Andaj, PSH mbështet veprimet e ekspertit shqyrtues dhe arsyetimin e dhënë në raport të ekspertizës nr. 283/2023, si dhe hulumtimit të bërë pas pranimit të shkresës nga MMPHI, ku ka konstatuar se, citat:

"Pas verifikimeve te cilat kam bërë në aktet ligjore të cilat janë bazuar ne kthim të përgjigjes se dhe vendimeve te cilat i kanë lëshuar për leje të importit për produkteve biocide kam hasur se MMPHI/DMMU ka shfrytëzuar directive evropiane (1451/07) e cila është e shfuqizuar nga 29.10.2014, ku vërtetohet se substance active e cila kemi kërkuar informacion ka qene e lejuar gjate kësaj periudhe, mirëpo me hyrje në fuqi të Rregullores Nr. 528/2012/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 22 Maj 2012, si dhe të direktivës evropiane për produktet biocide te lejuara për përdorim (Direktiva Evropiane Nr. 1062/2014 dt. 04.08.2014 si dhe plotësim/ndryshimi i datës 19.06.2022, preparatet me substanca active Sulfur nuk janë të lejuara. Kjo vërtetohet edhe bazuar në informatat nga Agjensioni Evropian për Kemikate (ECHA). Shih linkun e mëposhtëm."

https://echa.europa.eu/information-on-chemicals/biocidal-active-substances

Sipas konstatimeve të ekspertit shqyrtues tek raporti i ekspertizës 283/2023, se direktiva evropiane (1451/07) është shfuqizuar si dhe të direktiva evropiane për produktet biocide te lejuara për përdorim (Direktiva Evropiane Nr. 1062/2014 dt. 04.08.2014 si dhe

plotësim/ndryshimi i datës 19.06.2022, preparatet me substanca active Sulfur nuk janë të lejuara.

Andaj, Paneli Shqyrtues konform gjendjes së krijuar e klasifikon pjesërisht të bazuar ankesën e OE ankues, obligon autoritetin kontraktues Policia e Kosovës që gjatë fazës së ri-vlerësimit fillimisht të bëjë hulumtim të këtyre preparateve me substanca aktive të ngritura në pretendimet animore në ankesën 283/2023, dhe pas një konstatim të saktë nëse këto preparate janë të lejuara atëherë të filloj të bëjë ri-vlerësimin e ofertave në të kundërtën ta anuloj aktivitetin e prokurimit pasi që vije në shprehje shëndeti publik. Pastaj nëse ka ende interes ta ritenderoj dhe ti bëjë përmirësimet e domosdoshme në Dosje të Tenderit.

Me Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, ankuesi "S.V.Veterina" me nr. 292/2023, është eliminuar me arsyetimin se nuk e ka plotësuar kërkesën e DT, sa i përket referencave të cilat nuk janë të nënshkruara dhe nuk janë të vulosura dhe disa kontrata të punëtorëve, nenet përmbajnë gabime dhe janë kontradiktore njëra me tjetrën. Sa i përket asaj se nuk ka qenë kërkesë e Dosjes së Tenderit që këto referenca të jenë të nënshkruara dhe të vulosura. Nisur nga fakti se çdo dokument i cili lëshohet nga një palë në drejtim të palës tjetër në formë fizike me qëllim që të jetë i pranueshëm ai dokument së paku duhet të bëhet nënshkrimi i tij nga pala që e lëshon, kjo nuk është e qëndrueshme, por nisur nga fakti se ky aktivitet i prokurimit kthehet në ri-vlersim per shkak të pretendimeve te ngritura ne ankesën tjetër 283/2023, atëherë, nga ky aspekt PSH i jep të drejtë pjesërisht ankuesit pasi që OE punëtorët i ka të vetë dhe referencat lëshohen pas një kontrate apo aktiviteti të kryer më herët, kështu që këto punë të përfunduara mund të verifikohen përmes sqarimeve shtesë dhe kjo të bëhet në fazën e ri-vlerësimit dhe konform nenit 72. Andaj, PSH pjesërisht e mbështet raportin e ekspertizës.

Për shkak të natyrës në dukje relativisht komplekse të këtij aktiviteti të prokurimit dhe nisur nga kompetencat e tija në kuptim të nenit 99 lidhur me nenin 104 dhe 105, Paneli shqyrtues ka analizuar me kujdes te gjitha pretendimet ankimore, përfshirë të gjitha veprimet, aktet dhe korrespodencën mes palëve dhe nga ky kontekst mund të kuptohet AK nuk ka respektuar në tërësi dispozitat ligjore ashtu siç janë të sanksionuara me nenit 1, 6, 7, 27, 59 si dhe 24, paragrafi 2 i LPP, i cili
citon:"Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj."

Nga pikëpamja e këtij Paneli, raportet e ekspertizave përfshinë pretendimet ankimore të palëve, sikurse kërkohet shprehimisht me nenin 114 të LPP në kontekstin e përgjithshëm të vlerësimit të pavarur të secilit pretendim, në raport me natyrën e pretendimit dhe të shkeljeve të pohuara si dhe duke e pasur parasysh qëllimin, përmbajtjen dhe natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit.

Gjatë procesit të shqyrtimit dhe vendosjes, Paneli vuri si gjithnjë në zbatim edhe nenin 1, 6, 7, 24, 27, 59, 60, 103, 104 te LPP-së sipas të cilëve të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një subjekti në procedurë.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS, POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **FLOMED SH.P.K., S.V.„Veterina**
- Arkivës së OSHP-së: